



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ROSKOVEC

4533
Nr. _____ Prot.

Roskovec, më 12.06.2026

SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE

SPECIALIST PËR MBROJTJEN CIVILE NË BASHKINË ROSKOVEC

Në mbështetje të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, neni 64 , gërma “g” ; në Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin dhe Funkionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësi Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan” si dhe në Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 1, datë 06.01.2026 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum si dhe organigramës për vitin 2026”; ligj nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme i ndryshuar”,

Bashkia Roskovec shpall vendin e lirë të punës “Specialist për Mbrojtjen Civile” 1 (një) vend,

Afati i fundit i paraqitjes së aplikantëve është më datë 01.08.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të “Specialistit të Mbrojtjes Civile” janë,

1. Zbaton detyra lidhur me planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë.
2. Merret me organizimin, koordinimin e veprimtarisë së strukturave operacionale dhe strukturave të tjera në rastet emergjencave civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit .
3. Me grupet e punës merr pjesë në kryerjen e vlerësimeve të risqeve në territorin e bashkisë dhe me harton dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë .
4. Me grupet e punës harton dhe rishikon strategjinë e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë.
5. Harton dhe përditëson planin vendor për emergjencat civile.
6. Harton programet e masave të institucionit të bashkisë për menaxhimin e emergjencave civile verore dhe për përballimin e situatave të shkaktuara gjatë periudhës dimërore.
7. Ndjek situatën dhe menaxhon situatat e krijuara nga dukuri natyrore dhe ngjarje të lidhura me veprimtarinë njerëzore.
8. Verifikon dhe dokumenton të gjitha emergjencat e krijuara nga dukuri natyrore dhe ngjarje të lidhura me veprimtarinë njerëzore.
9. Harton dokumentacionin dhe paraqet në bashki, në këshillin bashkiak dhe të gjitha institucionet shtetërore përgjegjës për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar.

10. Merr masat me Bashkinë dhe bashkërendon punët me institucionet e tjera për evakuimin e banorëve në raste të emergjencës.
11. Merr masat për sigurimin e çadrave dhe materialeve të domosdoshme në rastet e emergjencave.
12. Është Sekretar i Komisionit të Mbrojtjes Civile në Bashkinë Roskovec, merr të gjitha masat për organizimin e mbledhjeve të KMC-së, kryen njoftimin, përgatit dhe shpërndan materialet përkatëse të mbledhjes në kohë, për secilin anëtar, si dhe mban procesverbalin e mbledhjes.
13. Njofton Kryetarin e Bashkisë për çdo ngjarje me pasoja të ndodhura në territorin e bashkisë duke propozuar masa.
14. Informojnë në mënyrë të vazhdueshme institucionin e Prefektit, agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në lidhje me investimet parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese.
15. Informon publikun dhe komunitetin e rrezikuar, bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut.
16. Organizon veprimtari trajnuese në fushën e mbrojtjes civile për punonjësit dhe banorët.
17. Merr në shqyrtim kërkesat ,ankesat e qytetarëve dhe kthen përgjigje brenda afateve ligjore.
18. Përgatitja e materialeve përkatës dhe kthim përgjigje të shkresave të ardhura.

B. Kriteret e punësimit të “Specialistit të Mbrojtjes Civile” janë:

- Të zotërojë një Diplomë Universitare të nivelit minimal “Bachelor” në shkencat ekonomike, menaxhimi, drejtësi, inxhinieri ndërtimi, gjeologjike, inxhinieri mjedisi , diplome arsim të lartë ushtarak/politor apo fusha të ngjashme me to (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.
- Ligji nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Per Mbrojtjen Civile”
- Ligjin Nr.9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;
- Ligjin Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
- Ligjin Nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”;
- Ligjin Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjes vendore”

C. Dokumentat që duhet të dorëzojnë të interesuarit, janë si më poshtë:

- Kërkesë për aplikim,
- Curriculum Vitae,
- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe listës së notave ;

- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- Vërtetim për eksperiencën e mëparshme të punës.

Dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet në protokoll, me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion (Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit – Bashkia Roskovec, brenda datës 01.02.2026.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 03.02.2026, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivave në Bashkinë Roskovec do të shpallë në web zyrtar të bashkisë dhe në standat pranë Bashkisë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të procedurës së punësimit do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit të Bashkisë Roskovec, në mënyrë elektronike, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivit në Bashkinë Roskovec do të shpallë fituesin në faqen zyrtre të Bashkisë Roskovec. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Juridike dhe Arkivave, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

KRYETAR
Majlinda Bufi

